



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MBROJTJES**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

(Urdhër i Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 35, datë 16.08.2021, i ndryshuar)

**SHTOJCË**

**PËR HEQJEN NGA PEZULLIMI DHE NDRYSHIMIN E KËRKESAVE PËR KUALIFIKIM TË PUBLIKUARA NË NJOFTIMIN E KONTRATËS (PJESË E DOKUMENTEVE TË TENDERIT) - TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT “PROCEDURË E KUFIZUAR” - PROKURIM NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË ME OBJEKT “PËRMIRËSIME NË HARDWARE, SOFTWARE DHE NDËRTIME TË DHOMAVE TË SERVERAVE, PËR RRIJTJEN E PERFORMANCËS SË SISTEMEVE TË MM/FA PËR VAZHDUESHMËRINË E PUNËS (BUSINESS CONTINUITY) SIPAS STANDARTEVE TË NATO-S, NË QENDRËN E NDËRLIDHJES TIK TË ASNI”. (ZBATIMI I KONTRATËS PËRFSHIN : PUNIME NDËRTIMI, PUNIME MEKANIKE, PUNIME ELEKTRIKE DHE INSTALIM PAJISJESH)”**

**(Kontratë - Punë)**

Autoriteti kontraktor, Ministria e Mbrojtjes bazuar në shkronjën ç), të nenit 3, të VKM nr. 1170/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe referuar njoftimit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP nr. 158, datë 1 Nëntor 2021 dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, njofton të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për heqjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit “Procedurë e kufizuar”, me objekt “Përmirësime në hardware, software dhe ndërtime të dhomave të serverave, për rritjen e performancës së sistemeve të MM/FA për vazhdueshmërinë e punës (business continuity) sipas standarteve të NATO-s, në Qendrën e Ndërlidhjes TIK të ASNI”. (Zbatimi i kontratës përfshin : punime ndërtimi, punime mekanike, punime elektrike dhe instalim pajisjesh).

Lidhur me sa më sipër, Autoriteti kontraktor, bazuar në nenin 46, të VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, për shkak të një ankese të paraqitur nga një operator ekonomik për dokumentat e tenderit dhe me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit dhe njoftimin e kontratës (në të cilin publikohen kërkesat për kualifikim për fazën e parë), nëpërmjet hartimit të kësaj shtojce.

Në njoftimin e kontratës (pjesë e dokumenteve të tenderit), të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Ministria e Mbrojtjes në buletin e njoftimeve publike nr. 151, datë 18.10.2021, të Agjencisë së Prokurimit Publik (faqet 296 - 299), bëhen këto ndryshime :

**Ndryshime në kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve në Fazën e Parë, janë si më poshtë :**

**Ishte :**

3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës, i cili duhet të jetë pjesë e përvojës së operatorëve ekonomikë në fushën objekt prokurimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën Korrik - Shtator 2021 kanë patur në dispozicion punonjësit si më poshtë :

- Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë më i ulët se 25 (njëzet e pesë) punonjës (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues).

Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

**Bëhet :**

3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës, i cili duhet të jetë pjesë e përvojës së operatorëve ekonomikë në fushën objekt prokurimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën Janar - Mars 2022 kanë patur në dispozicion punonjësit si më poshtë :

- Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë më i ulët se 25 (njëzet e pesë) punonjës (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues).

Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

**Ishte :**

4. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme :

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- N.P-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- N.S-10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- N.S-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N.S-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

**Bëhet :**

4. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme :

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- N.P-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- N.S-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N.S-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

➤ **Pika 8 e njoftimit të kontratës :**

**Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje (faza e parë):**

**Ishte :** 11/11/2021 (dd/mm/vvvv) Ora:10:00

**Bëhet :** 09/05/2022 (dd/mm/vvvv) **Ora:10:00**

Çdo kërkesë tjetër në njoftimin e kontratës, që nuk është përmendur në këtë shtojcë mbetet i pandryshuar.

Kjo shtojcë publikohet në buletinin e njoftimeve publike të APP dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, pasi procedura e prokurimit ka qënë e pezulluar dhe u vihet në dispozicion të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

Shënim: kjo shtojcë është publikuar edhe në buletinin e Njoftimeve Publike të APP nr. 43, datë 04.04.2022.

**NJËSIA E PROKURIMIT**